

Tiranë, më 7 Tetor 2021

KËRKESË PËR OFERTË
SUBJEKT TREGTAR PËR AKOMODIMIN DHE OFRIMIN E DARKËS PËR 11
PJESËMARRËS TË EVENTIT “KONFERENCË RAJONALE”

Hyrje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në zbatim të projektit “Drejt një dialogu më të madh ndërkulturor, ndërbesimtar dhe ndërjetar në Ballkanin Perëndimor”, mundësuar dhe mbështetur financiarisht nga organizata jofitimprurëse donatore DRA, Civic Solidarity Platform dhe Zyra Federale e Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë, shpall kërkesën për ofertë për një subjekt tregtar për akomodimin për 1 natë qëndrimi dhe darkën për 10 persona më datë 20 Tetor 2021, si dhe 1 person i cili do të jetë i akomoduar për 2 netë, më date 20 dhe 21 Tetor 2021.

Oferta financiare e cila duhet të përcillet nga ana e subjektit tregtar të interesuar duhet të përfshijë:

- Ofertën për akomodimin e 10 personave (secili në dhomë më vete), e preferueshme dhomë me krevat dopio.
- Oferta duhet të jetë e formatit half board pra të përfshijë mëngjes dhe akomodim.
- Ofertën për darkën si dhe menunë bashkëngjitur saj.
 - Oferta financiare për darkën nuk duhet të kalojë shumën 15 €/personi.

KShH fton të gjitha subjektet e interesuara që të dërgojnë në formë elektronike në adresën e e-mailit të KShH-së office@ahc.org.al ose postare, deri në datën 12.10.2021, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Ofertën financiare në Euro (me TVSH të përfshirë) *¹
2. Menunë e parashikuar për t’u ofruar.

¹ *Subjektet që nuk i nënshtrohen TVSH ta deklarojnë këtë status.

3. Foto të dhomës ku do të realizohet akomodimi (dhoma duhet të jetë në format të njëjtë për të gjithë pjesëmarrësit)
4. Çertifikatën e regjistrimit (nqs ofertuesi është kompani/subjekt tregtar)
5. Oferta duhet të jetë e firmosur dhe e vulosur